



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 9247 prot.

Himarë, më 30.12. 2025

VENDIM

Nr. 66, Datë 22/12/2025

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE 4 (KATËR) FAMILJEVE
PËR DËMTIMIN E BANESAVE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE
FATKEQËSI TË TJERA”**

Mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 54, ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-në nr.747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile”, VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin e organizimit të komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe të strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”, VKM-në nr.329 datë 16/05/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”. Në zbatim të urdhrit nr.634, datë 20.10.2025, “Për ngritjen e komisionit për konstatimin dhe evidentimin e dëmeve në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësive të tjera”, procesverbalit të konstatimit nr.1867/1 prot., datë 14.11.2025, relacionit nr. 7867/2 prot., urdhrit nr.704, datë 09.12.2025, “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të dëmeve në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësive të tjera”, relacionit dhe preventivave dërguar Kryetarit të bashkisë mbi vlerësimin e dëmeve në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësive të tjera nr.7867/4 prot., datë 19. 12. 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë; Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e datës 22.12.2025, pasi shqyrtoi materialin, e miratoi me 17 (shtatëmbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare 4 (katër) familjeve për dëmtimin e banesave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
2. Familjet që përfitojnë nga kjo ndihmë financiare për dëmtimin e banesave janë familjet e z. Viktor Nevraj, z. Riza Varfaj, z. Sherif Alikaj, z.Lavdosh Bejtaj, në masën financiare sipas relacionit mbi vlerësimin administrativ të dëmeve të konstatuara në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
HIMARË

Nr. 9247/11 prot.

Himarë, më 30.12. 2025

RELACION

**MBI VLERËSIMIN ADMINISTRATIV TË DËMEVE TË KONSTATUARA NË
BANESA NGA FATKEQËSITË NATYRORE OSE FATKEQËSI TË TJERA**

Në zbatim të Urdhrit Nr. 704, datë 09.12.2025, të Kryetarit të Bashkisë Himarë, për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve të konstatuara në banesa nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, sot më 17/12/2025, u mbledh Komisioni në përbërje:

Klodi Ajazaj – Kryetar

Maria Prifti – Anëtare

Kostandino Çela – Anëtar

• **QËLLIMI I AKTIT**

Kryerja e vlerësimit administrativ të dokumentacionit zyrtar ekzistues mbi dëmet e konstatuara në banesa, në përputhje me legjislacionin në fuqi, gjatë konstatimit në terren, u përgatit preventiv me zërat e manualit teknik bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

BAZA LIGJORE

Ky proces-verbal hartohet në mbështetje të:

Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”

Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

VKM nr. 329, datë 16.05.2012

Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”

Urdhrit nr. 704, datë 09.12.2025 të Kryetarit të Bashkisë Himarë.

- DOKUMENTACIONI BAZË I VLERËSIMIT

Komisioni kreu vlerësimin administrativ mbi bazën e:

Proces-verbalit të konstatimit të dëmeve nr. 7867/1 prot., datë 14.11.2025;

Relacionit shpjegues nr. 7867/2 prot., datë 20.11.2025;

Dokumentacionit fotografik bashkëlidhur;

Akteve shoqëruese administrative përkatëse. (Preventiv Teknik)

- KONSTATIME DHE VLERËSIM ADMINISTRATIV

Nga vlerësimi administrativ i dokumentacionit, Komisioni konstaton se:

1. Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve është kryer nga një komision i mëparshëm i posaçëm, i ngritur me akt administrativ, dhe përbën bazë dokumentare për vijimin e procedurave.

2. Komisioni i Vlerësimit ka kryer inspektime në terren, ka ushtruar veprime faktike dhe nuk ka marrë pjesë në verifikime fizike të objekteve.

3. Veprimtaria e Komisionit ka karakter administrativ dhe vlerësues, të kufizuar në dokumentacionin zyrtar ekzistues, duke hyrë në vlerësime teknike ose financiare.

4. Komisioni ka kompetencë ligjore për hartimin, verifikimin apo miratimin e preventivave, projekteve teknike apo llogaritjeve inxhinierike, pasi përbërja e tij dhe akti i ngritjes parashikojnë ushtrimin e funksioneve teknike të specializuara, të cilat, sipas VKM nr. 329, datë 16.05.2012, realizohen nga grupe ekspertësh të posaçëm ose struktura teknike kompetente.

5. Komisioni nuk përcakton dhe nuk rekomandon shuma konkrete financiare, pasi kjo përbën kompetencë të autoritetit vendimmarrës, sipas VKM nr. 329/2012.

• PËRFUNDIM

Komisioni vlerëson se dokumentacioni i administruar është i mjaftueshëm për vijimin e procedurave administrative nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KOMISIONI:

Klodi Ajazaj – Kryetar

Maria Prifti – Anëtare

Kostandino Çela – Anëtar

**Ky relacion ka karakter informues dhe vlerësues administrativ, përbën akt teknik, financiar apo vendimmarrës dhe nuk krijon përgjegjësi individuale apo kolektive për anëtarët e Komisionit lidhur me saktësinë teknike, vlerën financiare apo pasojat e vendimeve që merren mbi bazën e tij.*

Projektuesi: Klodi Ajazaj

Objekti:

Rikonstrukcion banese_Riza Varfaj

Datë:

19-12-2023

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMI MI	VLEFT A
		1. PUNIME DYER DRITARE				
1	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	2.0	44,441.55	88,883.11
2	2.395/1	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	9.0	16,468.24	148,214.12
		Shuma 1:				237,097.23
		2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
3	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	80.0	3,472.27	277,781.75
		Shuma 2:				277,781.75
		3. PUNIME BOJATISJE				
4	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	130.0	545.41	70,903.43
		Shuma 3:				70,903.43
Shuma Analiza						585,782.44
Fondi Rezervë (3.0%)						17,573.47
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						603,355.91
TVSH (20%)						120,671.18
Shuma me TVSH						724,027.09
Totali						724,027.06

Shënime:

Rikonstrukcion banese_Riza Varfaj

Objekti: Rikonstrukcion banese_Laydosh Bejtja
 Datë: 19-12-2025

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE				
1	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD-8m,tjegulla marseljeze	m2	90.0	4,169.28	375,235.20
		Shuma 1:				375,235.20
		2. PUNIME BETONI DHE B/A				
2	2.204	Brez b/a C20/25	m3	2.3	23,672.86	54,447.58
		Shuma 2:				54,447.58
		3. PUNIME DYER DRITARE				
3	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	2.0	44,441.55	88,883.10
		Shuma 3:				88,883.10
		4. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT				
4	1.143/p-a	Dritare druri dopio xham	m2	5.6	11,851.80	66,370.08
		Shuma 4:				66,370.08
Shuma Analiza						584,935.96
Fondi Rezervë (3.0%)						17,548.08
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						602,484.04
TVSH (20%)						120,496.81
Shuma me TVSH						722,980.84
Totali						722,980.84

Preventivuesi:

Klodi Ajazaj

Shënime:

Banese e demtuar nga fatkeqesia natyrore

Projektuesi: Klodi Ajazaj

Objekti: Rikonstruktion banese

Datë: 19-12-2025

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		1. PUNIME DYER DRITARE				
1	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	2.0	44,441.55	88,883.10
2	2.395/1	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	6.7	16,468.24	110,337.21
		Shuma 1:				199,220.31
		2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
3	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	95.0	3,472.27	329,865.65
		Shuma 2:				329,865.65
		3. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT				
4	1.117/p	Pragje dritare me granil	m2	2.3	2,454.37	5,645.05
		Shuma 3:				5,645.05
		4. PUNIME BOJATISJE				
5	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	95.0	545.41	51,813.95
		Shuma 4:				51,813.95
Shuma Analiza						586,544.96
Fondi Rezervë (3.0%)						17,596.35
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						604,141.31
TVSH (20%)						120,828.26
Shuma me TVSH						724,969.57
Totali						724,969.57

Preventivuesi:

Klodi Ajazaj

Shënime:

Rikonstruktion i banese ne emer te z. Viktor Nevraj, ndodhur ne fshatin Tërbaç

Projektuesi: Klodi Ajazaj

Objekti:

Rikonstruksion banese_Sherif Alikaj

Datë:

19-12-2025

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMI MI	VLEFT A
		1. PUNIME DYER DRITARE				
1	2.386/2	Dyer te blinduara	m2	2.0	44,441.55	88,883.11
2	2.395/1	F.V. Dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	9.0	16,468.24	148,214.12
		Shuma 1:				237,097.23
		2. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				
3	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	80.0	3,472.27	277,781.75
		Shuma 2:				277,781.75
		3. PUNIME BOJATISJE				
4	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	130.0	545.41	70,903.43
		Shuma 3:				70,903.43
Shuma Analiza						585,782.44
Fondi Rezervë (3.0%)						17,573.47
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						603,355.91
TVSH (20%)						120,671.18
Shuma me TVSH						724,027.09
Totali						724,027.06

Shënime:

Rikonstruksion banese_Sherif Alikaj

KRYETARI I KËSHILLIT

DHIMIRËR KAPAJ

